

PROJEKT-LIGJ

“PËR AGJENCINË E KTHIMIT TË GARANCIVE DHE KREDIVE”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

PJESA E PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj ka për objekt krijimin e Agjencisë së Kthimit të Garancive dhe Kredive dhe përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e saj.

Neni 2

Përkufizimet

Termat e përdorur në këtë ligj kanë kuptimin si më poshtë:

1. “aset” ose “asete” kanë këto kuptime:

- a. një pretendim për kredinë, përfshirë shumën e principalit dhe të interesave të llogaritur, mjetet e garancisë për sigurimin e detyrimit përkundrejt të gjithë personave fizikë ose juridikë, si dhe ato të zotëruara nga Agjencia, në mbështetje të nenit 4 të këtij ligji;
- b. pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme, që Agjencia i ka marrë në mbështetje të nenit 4 të këtij ligji”.

2. **“skema të veçanta garancie shtetërore”** – janë skema kolektive garancie, në bazë të të cilave lidhen marrëveshje të veçanta me shkrim, ku shteti është përgjegjës për detyrimet financiare të huamarrësve, kur ata nuk arrijnë t’i paguajnë ato në kohën dhe masën e duhur.
3. **“trajtimi i kredive”** – Ndjekja e rasteve, të kredive të prapambetura duke ezauruar rrugën gjyqësore dhe përmbarimore deri në likuidimin total të detyrimit.

Neni 3

Krijimi dhe financimi

1. Agjencia e Kthimit të Garancive dhe Kredive, në vijim “Agjencia” është person juridik publik, jo buxhetor, në varësi të Ministrit përgjegjës për financat, me seli në Tiranë.
2. Agjencia financohet nga:
 - a. Të ardhura nga trajtimi i kredive;
 - b. Transferta nga Buxheti i Shtetit, sipas ligjit vjetor të buxhetit;
 - c. Grante, donacione si dhe çdo burim tjetër i ligjshëm.
3. Programi buxhetor afatmesëm dhe buxheti vjetor i Agjencisë miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit përgjegjës për financat, në përputhje me legjislacionin përkatës për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.
4. Me miratimin e buxhetit vjetor të Agjencisë nga Këshilli Mbikëqyrës, çdo tepricë që rezulton, derdhet në favor të Buxhetit të Shtetit, brenda muajt janar të vitit pasardhës.

Neni 4

Funksionet e Agjencisë

1. Agjencia ka si funksion:
 - a. trajtimi i kredive dhe i aseteve të tjera, të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror;
 - b. trajtimin e portofolit të investimeve të kryera në banesa nga shoqëria INSIG sha, si dhe të aseteve të tjera, të transferuara me ligje të veçanta;
 - c. mbledhjen dhe kthimin e garancive shtetërore të huasë, dhe detyrimeve të huave dhe nënhuave, të dhëna nga Ministri përgjegjës për financat; Verifikimin e aftësisë paguese të subjekteve huamarrëse, në përputhje me Ligjin për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë;
 - d. Menaxhimin e disa aspekteve të skemave të veçanta të garancisë shtetërore
 - e. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave të kujdesit dhe vlerësimit të riskut nga ana e institucioneve huadhënëse në rastet e skemave të veçanta të garancisë.

2. Me qëllim realizimin e funksioneve të saj sipas pikës 1 të këtij neni, Agjencia kryen të gjitha veprimet ligjore sipas legjislacionit në fuqi, Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile, ligji për falimentin dhe barrën siguruese.

Neni 5

Organet drejtuese

Organet drejtuese të Agjencisë janë:

- a. Këshilli Mbikëqyrës;
- b. Drejtuesit e Agjencisë.

Neni 6

Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët janë:
 - a. Kryetari, i cili caktohet nga ministria përgjegjëse për financat;
 - b. Një anëtar në cilësinë e zëvendës Kryetarit, i cili caktohet nga Banka e Shqipërisë;
 - c. Dy anëtarë caktohen nga Kryeministri.
 - d. Një anëtar nga ministria përgjegjëse për ekonominë.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës caktohen për një periudhë kohore 3 vjeçare, me të drejtë riemërimi.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - a. Të jenë ekspertë në një nga fushat e financave, bankës, kontabilitetit ose drejtësisë;
 - b. Të kenë arsim të lartë;
 - c. Të mos jenë të punësuar, anëtarë të organeve drejtuese, ose zotërues aksionesh të bankave të nivelit të dytë, me seli në Republikën e Shqipërisë;
 - d. Të mos jenë gjykuar ndonjëherë për falimentim ose për paaftësi paguese;
 - e. Të mos kenë pengesa për të qenë të punësuar në shërbimin civil, sipas legjislacionit në fuqi;
 - f. Të mos jenë të përjashtuar më parë nga shërbimi civil.
4. Këshilli funksionon sipas legjislacionit në fuqi për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.

Neni 7

Kompetencat e Këshillit

1. Këshilli Mbikëqyrës është organi më i lartë vendimmarrës i Agjencisë.
2. Këshilli Mbikëqyrës ka këto kompetenca:
 - a) Emëron drejtuesit e Agjencisë si dhe lidh kontrata pune me ta;
 - b) Është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimeve të kryera nga Agjencia dhe të vendimeve të marra nga Drejtori i Përgjithëshëm sipas kompetencave të dhëna nga Këshilli Mbikëqyrës.
 - c) Shqyrton dhe miraton planin strategjik afatmesëm 3 vjeçar të veprimtarisë së Agjencisë.
 - d) Miraton strukturën, organigramën dhe rregullat e sjelljes së Agjencisë, të propozuara nga Agjencia.
 - e) Siguron që llogaritë financiare të Agjencisë të kontrollohen jo më pak se 1 herë në vit nga një ekspert kontabël i licensuar. Siguron gjithashtu që kontrollet të kryhen në bazë të standarteve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të kontroll-revizionit;
 - f) Miraton projekt programin buxhetor afatmesëm dhe projektbuxhetin vjetor të Agjencisë dhe e përcjell pranë Ministrit përgjegjës për financat.
 - g) Mbikëqyr e kontrollon përdorimin e fondeve financiare për shpenzimet operative
 - h) Ka përgjegjësi në marrjen e vendimeve për përmbushjen e detyrimeve, sipas këtij ligji;
 - i) Mund të ndryshojë, të shtojë, të revokojë ose të shfuqizojë kompetencat e drejtuesve të Agjencisë.
 - j) Miraton rregulloren e brendshme të punës së Agjencisë.
3. Këshilli Mbikëqyrës raporton me shkrim çdo 6 muaj:
 - a. përpara Këshillit të Ministrave për çështjet që lidhen me trajtimin e portofolit të kredive të rikuperuara dhe investimeve;
 - b. përpara Ministrit përgjegjës për financat për çështjet që lidhen me menaxhimin e skemave të veçanta të garancisë dhe kthimin e garancive shtetërore të huasë, huave dhe nënhuave, të dhëna nga Ministri përgjegjës për financat

Neni 8

Marrëdhëniet e punës në Agjenci

1. Agjencia drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë dhe 2 Zëvendësdyrektore të Përgjithshëm të cilët emërohen nga Këshilli Mbikëqyrës.
2. Drejtuesit e Agjencisë duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 3, të nenit 6 të këtij ligji.
3. Drejtuesit e Agjencisë do të punësohen nga Këshilli Mbikëqyrës sipas përcaktimeve të Kodit të Punës.
4. Punonjësit e administratës së Agjencisë lidhin marrëdhëniet e punës bazuar në kodin e punës.
5. Niveli i pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të Agjencisë përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, të propozuar nga Ministri përgjegjës për financat.

Neni 9

Drejtori i Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për:
 - a. drejtimin e veprimtarisë së përditëshme të Agjencisë;
 - b. përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët;
 - c. nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e tjera, në zbatim të dispozitave të këtij ligji;
 - d. kryerjen e detyrave të tjera që dalin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Agjencisë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Drejtori i Përgjithshëm është i detyruar të informojë Këshillin Mbikëqyrës për çdo të dhënë që lidhet me veprimtarinë e Agjencisë, në formën dhe mënyrën e kërkuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 10

1. Agjencia paguan taksën për veprimet që kryhen nga përmblyesit gjyqësor në fund të ekzekutimit dhe në raport me shumën e ekzekutuar.
2. Me qëllim realizimin e funksioneve të saj, Agjencia ka akses të drejtpërdrejtë në regjistrat shtetëror të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme.

KREU II

TRAJTIMI I KREDIVE

Neni 11

Kompetencat e Agjencisë

Me qëllim realizimin e funksioneve të saj, Agjencia ka të drejtë:

- a. të mbledhë nga debitorët ose nga ndonjë person tjetër të të gjithë ose të një pjese të detyrimit për kredinë e marrë;
- b. të ndryshojë termat e kredisë që rrjedhin nga marrëveshja e lidhur për këtë qëllim ndërmjet institucionit financiar dhe debitorit;
- c. të shesë sendet e luajtshme ose të paluajtshme, të kaluara në pronësi të Agjencisë, personave të tretë, fizikë apo juridikë, me kapital joshtetëror ose të kontrolluar nga shteti, sipas dispozitave ligjore në fuqi për shitjen e pronës shtetërore.
- d. të kërkojë nga organet gjyqësore dhe përmbarimore fillimin e procedurave të falimentit ose likuidimit, kundrejt personave fizikë apo juridikë të cilët kanë detyrime.
- e. të gëzojë të gjithë të drejtat që i takojnë nga aktet ligjore në fuqi për kreditorët, institucionet financiare dhe institucionet financiare jo-banka.
- f. të kalojë si kapital të vetë asetet e marra sipas gjurmës “d”, të këtij neni;
- g. të gëzojë të drejtat që institucionet financiare kanë pasur mbi debitorin, duke përfshirë dhe ndryshimet që mund ti ketë bërë me marrëveshje ndërmjet debitorit dhe asaj, përpara datës kur kredia është transferuar në pronësi të Agjencisë;
- h. të bëjë ndryshime në marrëveshjen e kredisë së transferuar asaj me debitorin, ndryshime që mund të përfshijnë:
 - i. zgjatjen e afatit të ripagesës së kredisë;
 - ii. faljen e së tërës ose të një pjese të detyrimeve të prapambetura për kamatvonesat, gjobat dhe shumën e interesave për principalin e kredisë;
 - iii. kthimin e sendit të marrë në pronësi, kundrejt likuidimit të detyrimit nëpërmjet një kontrate shkëmbimi me debitorin;
 - iv. ndryshimin e kushteve të kredisë në tërësi ose të pasurive të lëna si masë siguruese nga debitori;
 - v. shlyerjen e kredisë nëpërmjet sekuestrimit së pasurive të luajtshme ose të paluajtshme, të lëna si garanci apo siguri për përmbushjen e kredisë;

- i. pas marrjes së aseteve në pronësi të vet, sipas parashikimeve të këtij ligji, të pranojë zëvendësimin e debitorit në përputhje me nenet 496, 497, 498 të Kodit Civil, në rast se një zëvendësim i tillë është në interes të shlyerjes së kredisë;
- j. në rast se Agjencia pranon zëvendësimin e debitorit, ajo ka të drejtë të kërkojë nga debitori i ri vendosjen e garancive të reja për shlyerjen e kredisë, në ato raste kur garancitë e dhëna nga debitori nuk kanë qenë të barazvlefshme për shlyerjen e detyrimit. Në të gjitha rastet kur pranohet zëvendësimi i debitorit sipas këtij neni sendet e vendosura si garanci, ose garancitë e tjera të dhëna nga debitori i parë, mbeten në favor të agjencisë për atë kohë sa detyrimi të jetë shlyer në përputhje me marrëveshjen e lidhur ndërmjet Agjencisë dhe debitorit të ri, me qëllim ripagimin e detyrimeve;
- k. të marr në pronësi me pëlqimin e saj, sendin e lënë ose jo si kolateral, garanci apo dorzani, kundrejt vlerës së ankandit të fundit të zhvilluar nga përmbaruesi gjyqësorë. Në këtë rast, Agjencia zbret nga detyrimi vlerën e sendit sipas shumës së kontabilizuar.

Neni 12

1. Për huatë e transferuara në Agjenci pa dokumentacionin ligjor, që vërteton marrjen e kredisë, procesverbali i transferimit të detyrimit kontabël të këtyre huave përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga përmbaruesi gjyqësor.
2. Agjencia u dërgon zyra të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, drejtorive rajonale të shërbimit të transportit rrugor, zyra të gjendjes civile, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, organeve të pushtetit vendor, bankave të nivelit të dytë, institucioneve financiare jo banka, institucioneve të mikrofinancës dhe institucioneve të tjera, informacion për detyrimet që persona të ndryshëm mund të kenë ndaj shtetit.
3. Procedurat e shkëmbimit të informacionit përcaktohen në marrëveshjet e bashkëpunimit, të nënshkruara nga Agjencia dhe institucioni përkatës.

Neni 13

Detyrat e Agjencisë për menaxhimin e skemave të veçanta të garancisë

1. Kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marrë garanci nga skemat që ajo menaxhon dhe u kërkon huamarrësve informacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj mbikëqyrjeje.

2. Mbikqyr zbatimin e kushteve dhe kriterëve të dhënies së Skemave të Veçanta të Garancisë.
3. Krijon dhe përditëson bazën e të dhënave dhe regjistrin analitik të garancive që menaxhon.
4. Mbledh dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe raportimet e huadhënësve, përfshirë (por pa u kufizuar) si më poshtë:
 - kopjet e marrëveshjeve të huadhënësve me huamarrësit (marrëveshjeve të huasë) dhe të marrëveshjeve të mirëkuptimit
 - raportimet e huadhënësve.
5. Rakordon periodikisht të dhënat me huadhënësit dhe Ministrinë përgjegjëse për financat.
6. Raporton periodikisht në Ministrinë përgjegjëse për financat mbi ecurinë e skemave të garancisë.
7. Verifikon plotësimin e kushteve për pagesën e garancisë dhe ia përcjell atë Ministrit përgjegjës për financat në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në aktet ligjore apo nënligjore.
8. Ndjek shlyrjen e detyrimeve të huamarrësve ndaj Ministrisë përgjegjëse për financat për pagesat e kryera nga kjo e fundit në kuadër të marrëveshjeve të garancisë.
9. Mbledh tarifa dhe komisione nga bankat (kur marrëveshja parashikon të tilla) dhe i derdh ato në buxhetin e shtetit.
10. Dokumenton përfundimin e garancive që menaxhon dhe njofton Ministrin përgjegjës për financat.

KREU III

KTHIMI I GARANCISË SHTETËRORE TË HUASË, HUAVE DHE NËNHUAVE TË DHËNA NGA MINISTRI PËRGJEGJËS PËR FINANCAT

Neni 14

1. Me kryerjen e pagesës ndaj institucionit huadhënës, Ministri përgjegjës për financat njofton Agjencinë për fillimin e procedurave për kthimin e Garancisë Shtetërore të Huasë. Agjencia, ka të drejtë që, me anë të një urdhëri me shkrim të kërkojë bllokimin e llogarive dhe sekuestrimin e shumës, në vlerën e detyrimit të papaguar nga huamarrësi kundrejt Ministrisë përgjegjëse për financat dhe ndjek shlyerjen e plotë të detyrimit.
2. Nëse një huamarrës nuk shlyen në kohë detyrimet ndaj buxhetit për nënhuatë dhe huatë e marra prej tij, Ministria përgjegjëse për financat njofton Agjencinë për fillimin e procedurave për kthimin e tyre në buxhet. Agjencia, ka të drejtë që, me anë të një urdhëri me shkrim të kërkojë bllokimin e llogarive dhe sekuestrimin e shumës, në vlerën e detyrimit të papaguar

nga huamarrësi kundrejt Ministrisë përgjegjëse për financat dhe ndjek shlyerjen e plotë të detyrimit.

3. Urdhërat e nxjerrë sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni përbëjnë titull ekzekutiv.
4. Agjencia merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, në masën e çdo pagese të bërë në kuadër të garancisë së dhënë si dhe në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit.

Neni 15

1. Agjencia i drejtohet institucionit financiar për dorëzimin e plotë të dokumentacionit si dhe pasqyrën financiare të pagesave të realizuara nga huamarrësi, në rastin e skemave të veçanta të garancive.
2. Në funksion të rikuperimit të garancisë, Agjencia gëzon të gjitha të drejtat e përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji, përveç gërmave “b” dhe “h/ii” të tij.
3. Shumat e rikuperuara nga Agjencia në lidhje me pagesat e bëra nga Ministria përgjegjëse për financat në zbatim të marrëveshjeve të garancisë, si edhe shumat e rikuperuara për huatë dhe nënhuatë e dhëna nga Ministri përgjegjës për financat, derdhen në buxhetin e shtetit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga rikuperimi.

Neni 16

Agjencia nuk ka të drejtë t’u shesë institucioneve financiare, bankare ose jo bankare, dhe zyrave përmbarimore shtetërore apo private, mbledhjen e detyrimeve të debitorëve, për të cilat është ngarkuar nga ky ligj.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

1. Këshilli i Ministrave me vendim përcakton:
 - a. Procedurat për trajtimin e kredive, objekt i këtij ligji.
 - b. Procedurat për kthimin e garancive shtetërore të huasë, huave dhe nënhuave të dhëna nga Ministri përgjegjës për financat
2. Marrëdhëniet e Agjencisë me Ministrinë përgjegjëse për financat lidhur me menaxhimin e skemave të veçanta të garancive (objekt i këtij ligji), kthimin e garancisë shtetërore të huasë, huave dhe nënhuave të dhëna nga Ministri përgjegjës për financat, përcaktohen në një udhëzim të veçantë të Ministrit përgjegjës për financat

Neni 18

Dispozitë tranzitore

1. Kreditë, asetet, pasivet dhe kapitali i Agjencisë së Trajtimit të Kredive, të marra prej saj sipas ligjit nr.8894, datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive" i ndryshuar, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, i kalojnë në pronësi kësaj Agjencie.
2. Personeli i Agjencisë së krijuar sipas ligjit nr.8894, datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive" i ndryshuar, i transferohet Agjencisë.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të caktuar sipas ligjit nr.8894, datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive" i ndryshuar, vijojnë mandatin e mbetur. Caktimi i anëtarëve të rinj bëhet sipas këtij ligji.

Neni 19

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore sipas nenit 8 dhe 17 të këtij ligji.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore sipas nenit 20 të këtij ligji.

Ngarkohet Ministri përgjegjës për financat që, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore sipas neneve 17 të këtij ligji.

Deri në hyrjen në fuqi të akteve nënligjore të këtij ligji, vijojnë aktet nënligjore sipas ligjit nr.8894, datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive" i ndryshuar.

Neni 20

Ligji nr.8894, datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive" i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI